



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBOHOVË
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. _____ Prot

Libohovë , më ____ .07.2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROCEDURËS: “**Blerje karburant**”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Karburante:	09100000-0
Gaz i lëngshëm propan:	09122110-4
Gaz butan:	09122200-2
Benzinë:	09132000-3
Naftë:	09134000-7

VLERA E FONDIT LIMIT /vlera e pritshme e kontratës: **6,890,925** (gjashtë milionë e tetëqind e nëntëdhjetë mijë e nëntëqind e njëzetë e pesë) lekë pa TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Libohovë** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të paraqesë:

- Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*
- Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP-së, nenit 26, të

VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Ofertuesi duhet të paraqesë:

1.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme): Kjo pikë plotësohet me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1.1.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë kopje të deklarimit të xhiros vjetore gjatë 3 (tre) viteve të fundit ushtrimore (2023 ,2024, 2025) lëshuar nga autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 30% të vlerës së përlogaritur të kontratës

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Në zbatim të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 55, pika 4, “Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40 % të vlerës së përlogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave”. Referuar parashikimeve ligjore të nenit 43, pika 2, germa c), për procedurat nën kufirin e ulët monetar, siç është rasti i kësaj procedure.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është kryer bazuar në VKM-në nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e cila parashikon se Autoriteti koonraktor për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike mund të kërkojë për një periudhë maksimumi deri në 3 vitet e fundit financiare. Kjo është një kërkesë e cila nuk e pengon konkurrencën dhe është e bazuar në garancinë që ofertuesi i paraqet Autoritetit Konraktor.

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore).

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore).

Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë kopje të bilanceve, të certifikuara nga autoritetet përkatëse (Dega e Tatim Taksave) për vitet 2023, 2024 dhe 2025 **ku të paktën në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës,

konkretisht, nenit 41, të ligjit Nr. 10 091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare”, përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese.

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese).

Kapaciteti teknik:

1.1.2 Furnizime të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se 20 % fondit limit, të ekzekutuar gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës:

- Kur furnizimet janë realizuar me entet publike duhet të paraqitet kontrata e ngjashme me entin që ka realizuar këtë lloj furnizimi shoqëruar me vërtetimin e realizimit me sukses nga Autoriteti kontraktor.
- Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të deklaruar në organet tatimore ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara e firmosur dhe vulosur nga palët.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më të madhe se 40% të vlerës së përllëgaritur të kontratës.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Në zbatim të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, nenit 55, pika 4, germa b) në vlerën 20% të fondit limit.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

Argumentimi: Mbështetur në ligjin 8450 datë 24/02/1999 “Për përpunimin, transportimin e naftës dhe nënprodukteve të tjera” me ndryshimet përkatëse.

1.1.3 Subjekti ofertues duhet të ketë stacion të tregtimit me pakicë të karburantit brenda territorit të Bashkisë Libohovë ose Dropull vërtetuar me një nga format e disponimit sipas Kodit Civil (kontratë noteriale qeraje ose akt pronësie). Stacioni i tregtimit me pakicë të karburantit detyrimisht duhet të jetë i pajisur me leje mjedisore të tipit B të lëshuar nga QKL, Vërtetim teknik lëshuara nga ISHTI ose Organet e Miratuara të Vlerësimit të Konformitetit (OMVK),

Argumentim: : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 5, gërma a,) të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe në zbatim të ligjit nr.8450, datë 24.02.1999, “Për përpunimin,transportimin dhe tregëtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, VKM-së nr.147, datë 21.03.2007 “Për cilësinë e lëndëve djegëse benzinë dhe diesel”, VKM-së nr.970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe

kushteve për dhënien e licensave për tregëtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” për tregëtimin e këtyre produkteve, VKM-së nr.344, datë 19.04.2017, “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin në VKM-në nr.970, datë 02.12.2015 ”Për përcaktimin e procedurave dhe kushteve për dhënien e licensave për tregëtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” për tregëtimin e këtyre produkteve të saj”,

Vërtetim teknik nga ISHTI është vërtetimi që lëshohet për respektimin e normave dhe kushteve teknike në instalimet teknologjike) sipas urdhrit nr. 315 datë 24.08.2017 të Ministrit. Për procedurat e lëshimit të vërtetimit teknik për subjektet që kryejnë aktivitet në fushën e përpunimit, transportimit dhe tregëtimin të naftës dhe nënprodukteve të saj.

1.1.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një vërtetim të lëshuar nga ISHTI, që subjekti ofertues ka tregtuar karburante sipas standarteve të legjislacionit shqiptar, dhe nuk ka patur penalitete për shkelje të cilësisë për vitin e fundit.

Argumentim: Ky kriter është vendosur nga ana e AK në zbatim të kërkesave që përcakton ligji nr.8450, datë 24.02.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregëtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, VKM nr.147, datë 21.03.2007 “Për cilësinë e lëndëve djegëse benzinë dhe diesel”, VKM nr. 970, datë 02.12.2015 ”Për përcaktimin e procedurave dhe kushteve për dhënien e licensave për tregëtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” për tregëtimin e këtyre produkteve, VKM nr 344, datë 19.04.2017, “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin në VKM nr. 970, datë 02.12.2015 ”Për përcaktimin e procedurave dhe kushteve për dhënien e licensave për tregëtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” për tregëtimin e këtyre produkteve të saj”, Urdhërit nr.315, date 24.08.2017 “Për procedurat e lëshimit të vërtetimit teknik për subjektet që kryejnë aktivitet në fushën e përpunimit, transportimit dhe tregëtimin të naftës dhe nënprodukteve të saj”. Plotësimi i këtij kriteri garanton zbatimin e kontratës gjatë periudhës së zbatimit duke treguar që OE ofertues në aktivitetin e tij periodik zbaton rregullat dhe ligjet në fuqi.

1.1.5 Pika e karburantit të jetë e pajisur me autorizim për tregim karburanti të lëshuar nga njësi vendore ku ushtron aktivitetin. (Autorizimi duhet të jetë në emër të operatorit ekonomik pjesëmarrës në tender).

Argumentim: Ky kriter është vendosur nga ana e AK në zbatim të kërkesave që përcakton ligji nr. 8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregëtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar me ligjin nr. 71/2014, neni 4 dhe neni 20, pika 2.

1. Subjekti duhet të deklarojë, se merr përsipër furnizimin me karburant në çdo ditë me shërbim 24 orë, sipas nevojave që ka Autoriteti Kontraktor.
2. Operatori/et Ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë ku duhet të kryejnë furnizimin e sasisë së karburantit nëpërmjet kartave elektronike të personalizuar për çdo automjet të Autoritetit Kontraktore.
3. Subjekti duhet të deklarojë se e zotëron dhe e mundëson pajisjen e Autoritetit Kontraktor me Sistemin Elektronik të Vetmenaxhimit të karburantit.

- Bazuar në VKM Nr. 561 datë 29.07.2016“Për Standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njësitë e qeverisjes së përgjithshme“ operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të ofrojnë një faqe menaxhimi të karburanteve (webpage), ku furnizimi dhe shpenzimi i karburantit të kryhet nëpërmjet kartës elektronike të personalizuar me të dhënat e mjetit.

- Faqja e menaxhimit të karburanteve (webpage) duhet të ofroj shërbimin e ngarkimit të sasisë së karburantit nga Operatori ekonomik drejt Autoritetit Kontraktor, me qëllim që rimbushja e kartave elektronike të personalizuar me të dhënat e mjetit si dhe administrimi i sasisë së karburanteve të kryhet në mënyrë të pavarur nga vetë Autoriteti kontraktor.

- Faqja e menaxhimit të karburanteve (webpage) duhet të ofroj informacion dhe raporte të ndryshme të lëvrimit dhe qarkullimit të karburantit, të jetë e pavarur dhe e kontrollueshme nga vet Autoriteti Kontraktor.
- Mos ofrimi i shërbimeve të kërkuara më sipër në mënyrë elektronike nëpërmjet Faqes së menaxhimit të karburanteve (webpage), që ofron çdo operator ekonomik pjesëmarrës përbën kusht për skualifikim.

1.1.6 Certifikat ISO:

a) **ISO 9001-2015 – Standard per Sistemin e Menaxhimit te Cilësisë (e vlefshme) ose ekuivalente**, Certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi:

Kjo certifikatë mundëson që shoqëria të punojë me standarde e cilësi në menaxhimin, identifikimin e riskut dhe mundësive, sigurimin e konkurrencës për personelin e shoqërisë, mirëmbajtjen e pajisjeve dhe infrastrukturës, matjen e kënaqësive të klientëve, përgjigjen ndaj ankesave të marra dhe vlerësimin e furnitorëve, krijimin e një imazhi më të mirë në sytë e klientëve.

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” si dhe në Kodin e punës, ligji nr. 7961, datë 12.07.1995, i ndryshuar, ligjin nr.10237 date 18.02.2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë", VKM-në nr. 562, datë 03.07.2013 “Për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në përdorimin e pajisjeve të punës në vendin e punës”, VKM-në nr. 563, datë 03.07.2013 "Për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit për përdorimin e pajisjeve mbrojtëse individuale në vendin e punës”.

NJËSIA E PROKURIMIT

Kristaq Ciko

Xhelil Tusuni

Llazar Meksi